

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE, gjyqtari Besim Susuri, me procesmbajtësen Firdes Santuri, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Çemailj Kurtishi, nga fshati Lubinje e Poshtme Komuna e Prizrenit, për shkak të kundërvajtjes nga neni 15 par.3 të ndëshkuar sipas nenit 17 par.1 lidhur me par.1.5 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë nr. 04/L-050, në bazë të nenit 31,73 dhe 198 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me datë 23 dhjetor viti 2013 marr këtë:

AKTVENDIM

Konform nenit 198 par.1 nënpar.8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, **PEZULLOHET**, procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit **Çemailj Kurtishi**, nga i ati Ramo, i lindur më 14.06.1960 në fshatin Lubinje e Poshtme Komuna e Prizrenit, për shkak të kundërvajtjes nga neni 15 par.3 të ndëshkuar sipas nenit 17 par.1 lidhur me par.1.5 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë nr. 04/L-050, **në mungesë të provuarit**, nga se nuk është provuar se i përmenduri ta ketë kryer kundërvajtjen për të cilën është paraqitë, apo edhe të ndonjë kundërvajtjeje tjetër.

Shpenzimet e procedurës kundërvajtëse bien në barrë të mjeteve bugetore të kësaj gjykate

Arsyetim

Duke vepruar sipas kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse të Agjencisë Kundër Korrupsion në Prishtinë, me nr. 01-1911/12 të datës 24.05.2012, është zhvilluar procedurë kundërvajtëse kundër të pandehurit Çemailj Kurtishi, Zv. Kryesues i Kuvendit komunal në Prizren, për shkak të kundërvajtjes nga neni 15 par.3 të ndëshkuar sipas nenit 17 par.1 lidhur me par.1.5 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë nr. 04/L-050.

Gjendja faktike e përshkruar më për së afërmi si në dispozitiv të aktvendimit është vërtetuar në bazë të kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse të Agjencisë Kundër Korrupsion në Prishtinë, me nr. 01-1911/12 të datës 24.05.2012, nga mbrojtja e të pandehurit, dëshmia e dëshmitarit, Samir Hoxha zyrtar kontaktues për Kuvendin Komunal të Prizrenit, Ibrahim Krasniqi, shef i shërbimit profesional të KK Prizren dhe dëshmisë së Enis Sadikut, zyrtar i Agjencionit Kundër Korrupsion dhe me administrimin e provave tjera nga shkresat e lëndës.

I pandehuri **Çemailj Kurtishi**, në mbrojtjen e vetë të dhënë në këtë gjykatë, mohoj në tërësi kryerjen e kundërvajtjes për të cilën ngarkohem sipas kërkesës së Agjencionit Kundër Korrupsion në Prishtinë, konsideron se obligimin të cilin e ka pas si Zyrtar Publik në tërësi e ka përmbush, kjo mund të vërtetohet nga formulari për deklarimin e pasurisë të cilin ia prezantoi gjykatës, nga e cila vërtetohet se me datë 29.02.2012 e ka përmbush këtë obligim dhe se gjithmonë pas plotësimit të formularit për deklarimin e pasurisë të njëjtin ia kishte dorëzuar Ibrahim Krasniqi, zyrtar në KK Prizren.

Nga deklarata e dëshmitarit **Samir Hoxha**, Zyrtar Kontaktues në KK Prizren, se për vitin 2012 ka qenë zyrtar Kontaktues me AKK-në, ndërsa tani nuk është, deklaron se Agjencioni Kundër Korrupsion, i ka njoftuar ata që ti njoftojnë të gjithë Kuvendarët përkitazi me afatin ligjor për deklarimin e pasurisë-deklarimin vjetor, të njëjtin gjë ia ka përcjellë shefit të shërbimit profesional për punë të Kuvendit **Z. Ibrahim Krasniqi**, i cili ka pas për

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr Prot Br Prot Prot No.
<u>DPK/DMP</u>	<u>03-93/14</u>
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
<u>02</u>	<u>10-01-2014</u>
PRISHTINE	

